

Kristina Jorgaqi

**Një tjetër sprovë për krijimin e një modeli shqipeje
letrare të përbashkët**

(Poema “Mili e Haidhia” e Giuseppe Schirò-it)

Përmbledhje

Pas “eksperimentit” të parë gjuhësor të kryer prej Dhimitër Kamardës për krijimin e një modeli shqipeje letrare të përbashkët, që përsëri një arbëresh, Zef Skiroi, që bëri përpjekjen e dytë të këtij lloji. Modelin e shqipes së përbashkët ai u përpoq ta realizonte duke përpunuar gjuhën e poemës së vet “Mili e Haidhia”, konkretisht duke e hapur atë gjithnjë e më tepër ndaj shqipes së atdheut të tij historik përmes zëvendësimit të fjalëve, modeleve fonetike dhe gramatikore të arbërishtes me fjalë e struktura të toskërishtes e të gegërishtes. Në artikull ndiqet e analizohet dinamika e këtyre përpjekjeve si dhe shqyrtohen idetë dhe konceptet e Skiroit për krijimin e një varieteti letrar të përbashkët të shqipes. Evidentohen, gjithashtu, arsyet pse Skiroi nuk ia doli ta krijonte, sikurse kishte aspiruar, një model shqipeje letrare të përbashkët si një përzierje ndërdialektore mes toskërishtes, gegërishtes dhe arbërishtes.

Fjalët kyçe: *shqipe letrare, shqipe e përbashkët, arbërisht, toskërisht, gegërisht, përzierje dialektore.*

“Eksperimentimet” për një shqipe të shkruar të përbashkët për të gjithë shqiptarët zunë fill pikërisht mes elitës kulturore arbëreshe të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit pasardhës. Të parën sprovë të këtij lloji do ta realizonte Demetrio Camarda / Dhimitër Kamarda (1821-1882) në v. 1867 duke përkthyer nga frëngjishtja në shqip veprën e Dora D’Istrias *La nationalité albanaise d’après les chants populaires*¹, pasi i kishte parashtruar më parë idetë e tij për krijimin e një gjuhe letrare shqipe në hyrjen e një studimi² si dhe në

¹ Dora D’Istria, *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*, enkëthyeme në shkjipte përej D. Camarda, *Prekallëzimë* (Livorno: 1867).

² Demetrio Camarda, *Appendice al saggio de grammatologia comparata sulla lingua Albanese* (Prato: 1866).

korrespondencën me Jeronim de Radën (1814-1903)³. Në to ai mbronte idenë se shqipja e përbashkët nuk mund të krijohej duke u mbështetur tërësisht mbi një dialekt të vetëm, por në përzierjen e elementeve prej të folmeve të ndryshme dialektore të përzgjedhura sipas kriteresh të paracaktuara (Jorgaqi, *Pionierët...*, 398-400). Këto kritere ai i shtjelloi në hyrjen e gjatë studimore, të titulluar *Prekallëzimë*, që i paraprinte përkthimit, duke e ofruar këtë si një model të shqipes letrare. Modeli i Kamardës, ndonëse kishte në bazë të folmen arbëreshe të Sicilisë, përbante të mbishtresuara mjaft elemente fonetike e morfologjike nga të folme të ndryshme toske e gege si dhe një leksik të pasuruar prej huazimesh nga greqishtja e gjuhët neolatine dhe fjalë të reja të formuara sipas modeleve të shqipes e të gjuhëve të tjera⁴. Kjo “gjuhë letrare e përbashkët shqiptaro-epirote”, siç e quante Kamarda “produktin” e tij, nuk pati në të vërtetë kurrfarë njohjeje e përhapjeje në mjedisin arbëresh dhe aq më pak në atdheun historik të tij për arsye që kishin të bënin jo thjesht e vetëm me ndërtimin e saj, por mbi të gjitha për arsye jashtëgjuhësore (Jorgaqi, *Pionierët...*, 403-404). Ajo, madje, mbeti në harresë e larg vëmendjes së studiuesve për rreth një shekull e gjysmë për ta zgjuar interesin e tyre vetëm pak më shumë se një dekadë më parë.

Pas Kamardës, një tjetër sprovë për krijimin e një modeli shqipeje letrare të përbashkët ndërmori poeti, studiuesi dhe publicisti arbëresh Giuseppe Schirò / Zef Skiroi (1865-1927) kryesisht përmes përpunimit gjuhësor të veprës së tij poetike, idilit *Mili e Haidhia*⁵. Idilin, të cilën autori e shkroi dhe e botoi së pari në rininë e tij (1890)⁶, e ripunoi përgjatë 2-3 dekadave edhe tri herë të tjera, nga të cilat dy variante u botuan në gjallje të tij (1900, 1907)⁷, kurse varianti i tretë

³ Kristina Jorgaqi, “Pionierët e mendimit mbi shqipen e përbashkët”. Në *Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike*, vëll. II, Gjuhësi dhe antropologji (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, 2022), 393-403.

⁴ Gëzim Gurga, “Idiolekti “letrar” i Kamardës në dritën e veprës *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*”. *Hylli i dritës*, nr.1, 112-124 (Shkodër: 2011).

Anila Omari, “Dhimitër Kamarda dhe idetë e tij rilindase për gjuhën shqipe”. Në *Gjurmime albanologjike. Hulumtime për ndihmesat e disa albanologëve për kulturën shqiptare*. (Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 2019), 65-72.

⁵ Do t’i përmbahemi në artikullin e këtij titulli, me të cilin del vepra në variantin III dhe IV, përkundrejt titullit *Milo e Haidhee* të variantit I dhe II të saj.

⁶ Giuseppe Schirò, *Milo e Haidhee*, Idillio. Në *Archivio Albanese*, fasc. IV (Palermo: Tipografia “G. Spinnato”, 1890), f. 1-24.

⁷ Giuseppe Schirò, *Te dheu i huaj (Nella terra straniera. Poema – Mili e Haidhia. Idillio*, 2^a edizione, (Palermo: Tipografia “G. Spinnato”, 1900), 95-136 (ribotuar në Giuseppe Schirò, *Opere*, II, *Milo e Haidhe*, përg. Matteo Mandalà. (Cosenza: Rubbettino Editore, 1997), 71-166).

u botua si *opus postumum* shumë vite më vonë prej botuesit të veprës së plotë dhe studiuesit të mirënjohur të tij Matteo Mandalà⁸. Gjuha e tri varianteve të fundit të kësaj vepre dëshmon qartë, siç do të shihet më poshtë, dinamikën e përpjekjeve të Skiroit për të kontribuar në krijimin e një varieteti letrar të përbashkët të shqipes⁹.

Milo e Haidhee (1890), ndonëse ndër të parat krijime të gjata poetike të Skiroit (bashkë me *Rapsodie Albanesi*¹⁰), tërhoqi vëmendjen e rretheve intelektuale arbëreshe jo thjesht për faktin se i kushtohej një shkrimtari të madh si Luigi Pirandello, shok gjimnazi i autorit, por për cilësitë letrare. Vepra i kapërceu, madje, kufijtë gjeografikë të vendit ku u krijua, aq sa Faik Konica, me të nisur botimin e revistës *Albania*, e përktheu në frëngjisht (pas gjasash, prej variantit italisht) dhe e botoi atë në disa numra¹¹.

Mund të hamendësohet që Skiroi u bë shpejt i vetëdijshëm që vepra, e shkruar në varietetin arbëresh të *Piana degli Albanesi* të Sicilisë, mund të haste vështirësi për t'u lexuar e përhapur mes lexuesve shqiptarë. Si një admirues i zjarrtë i De Radës në rininë e vet dhe ndjekës i gjurmëve të tij në shumë aspekte, Skiroi e ka ditur se vepra e De Radës, ashtu sikurse ajo e shkrimtarëve të tjerë arbëreshë (Anton Santori, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe etj.) nuk kishte arritur të bëhej e njohur në atdheun e tyre historik, veç të tjerash, edhe për shkak të shqipes arkaike¹². Kishte ardhur koha që të dy letërsitë, ajo arbëreshe dhe ajo shqiptare, që kishin lindur e ishin zhvilluar krejt ndarazi prej njëra-tjetrës, pa pasur kurrfarë njohjeje e lidhjesh të ndërsjella, të krijonin pika kontakti e të nisinin të hapeshin ndaj njëra-tjetrës. Ambicia e Skiroit, sikurse dëshmon Namik Ressuli, një prej studiuesve të tij, ishte pikërisht afrimi e më

Giuseppe Schirò, *Mili e Haidhia*, Idhill ndë gjuhë shqipe (I përkëthyer edhe italisht fjalë pas fjale), Shpalleje e tretë. (Napoli: Tipografia Edit. Cav. "Tocco & Salvietti", 1907) (ribotuar në Giuseppe Schirò, *Opere*, II, *Milo e Haidhe*, përg. Matteo Mandalà. (Cosenza: Rubbettino Editore, 1997), 167-282).

⁸ Giuseppe Schirò, *Opere*, II, *Milo e Haidhe*, përg. Matteo Mandalà. (Cosenza: Rubbettino Editore 1997), 283-373.

⁹ Në ndryshim prej Kamardës, i cili kishte marrë një formim filologjik e gjuhësor si dhe kishte bërë një karrierë të dalluar në këto fusha duke botuar vepra me vlerë, Skiroi ishte arsimuar në fushën e drejtësisë. Gjithsesi, ai kishte një formim të mirë në gjuhët dhe letërsinë klasike greke e romake, njohje shumë të mirë të shqipes si dhe një veprimtari të pasur publicistike, studimore dhe letrare.

¹⁰ Giuseppe Schirò, *Rapsodie Albanesi* (Palermo: Andrea Amenta Editore, 1887) (ribotuar në Giuseppe Schirò, *Opere*, I, *Kroja, Rapsodie Albanesi*, përg. Matteo Mandalà. (Cosenza: Rubbettino Editore, 1997), 39-161).

¹¹ Revista *Albania*. (Bruxelles: Trhank Spirobeg, 1897), n. 3, 4, 5, 7, 8, 10.

¹² Namik Ressuli, "Giuseppe Schirò fra due letterature". Në *Annuario Accademico 1965-66: Atti del IV Convegno Internazionale di Studi Albanesi*. (Palermo: Centro Internazionale di Studi Albanesi, Università di Palermo, 1966), 146-147.

pas bashkimi i letërsisë arbëreshe me trungun e letërsisë së atdheut të origjinës (Ressuli, *Giuseppe Schirò ...*, 149). Dhe mënyra më efikase për ta bërë këtë ishte krijimi i një gjuhe letrare të përbashkët. Në funksion të kësaj ideje Skiroi ndërmori ripunimin e poemës *Mili e Haidhia* dhe botimin e saj pas gati një dekade (1900), variant ku spikasnin risi jo vetëm të natyrës stukturore-letrare, por edhe të karakterit gjuhësor (Mandalà (përg.), *Giuseppe Schirò, Opere, II ...*, XI-XII). Këto të fundit kishin të bënin me zëvendësimin e një numri fjalësh e trajtash prej të folmeve arbëreshe me fjalë e trajta më të përgjithshme, të cilat i takojnë mbarë të folmeve toske të trojeve të banuara prej shqiptarëve. Për të krijuar një ide të këtyre ndryshimeve gjuhësore, po kufizohemi të japim një krahasim të Këngës I në variantin e parë dhe variantin e dytë të poemës¹³.

Ndryshimet në botimin e dytë, siç mund të shihet më poshtë, janë të pakta: në një këngë prej 89 vargjesh janë ndryshuar vetëm 6 fjalë e trajta fjalësh. Konkretisht, fjalë e trajta me një përhapje shumë të ngushtë, pra, vetëm në të folmet arbëreshe, janë zëvendësuar me fjalë e trajta që janë pasuri e përbashkët për mbarë toskërishten.

I (I)	I (II)
(A) ¹⁴ ndë	(ATG) në
(A) i hjezuarith	(AT) i vrërët “jo i kthjellët”
(A) horës	(AT) katundit
(A) kopilezit	(AT) vashazit
(A) e bljerme “e artë”	(AT) t’aart
(A) i liir “i lehtë”	(ATG) t’leet

Këto ndryshime të pakta, që përfaqësojnë një hapje të ndrojtur të gjuhës së Skiroit, vetëm ndaj të folmeve toske të shqipes, duhet ta kenë lënë të pakënaqur poetin përderisa, pa u mbushur ende një dekadë, e ripunoi përsëri veprën duke bërë një botim të tretë të saj.

Varianti i tretë (1907) vinte me shumë risi: me titull të ndryshuar (nga *Milo e Haidhee* në *Mili e Haidhia*); me një kushtim për Prenk Doçin, abatin e Mirditës, me një parathënie të shkruar prej Luigj Gurakuqit; si dhe një parathënie të hartuar prej vetë Skiroit. Por, mbi të gjitha, vepra përmbante, sikurse e pranonte edhe vetë poeti, “ndryshime të shumta e të rëndësishme” (Schirò, *Mili e Haidhia*, 57) duke u paraqitur kështu e “transformuar thuajse tërësisht nga pikëpamja gjuhësore” (Ibid., po aty). Llojin e këtyre ndryshimeve gjuhësore, së bashku me qëllimin që kishte pasur për t’i realizuar ato, ai i bënte

¹³ Këto dy variante të këngës janë dhënë të plota te *Shtojca I* në fund të artikullit, ku me shkronja të zeza janë evidentuar ndryshimet e gjetura.

¹⁴ A - arbërisht, AT – arbërisht, toskërisht, ATG – arbërisht, toskërisht, gegërisht.

të qarta në pasthënien e shkruar në italisht të veprës, të titulluar *Nota* (“Shënime”).

Përpunimi i thellë i gjuhës së idilit *Mili e Haidhia* në këtë variant të tretë nuk ishte thjesht një trill gjuhësor-letrar i Skiroit poet, por, siç del qartë edhe në pasthënie, përpjekja e parë e një sprove modeste për një gjuhë të përbashkët¹⁵, një kontribut për krijimin e një gjuhe letrare kombëtare¹⁶. Përfshirja aktive Skiroit në çështjen e krijimit të një varieteti letrar të shqipes nuk do të ishte, në fakt, as e papritur dhe as e rastësishme. Ai kishte rreth 7 vjet që mbante pozicionin e profesorit të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Institutin Oriental të Napolit, pozicion në të cilin qëndroi deri në fund të jetës (1900-1927). Gjatë kësaj periudhe veçanërisht, por edhe më përpara, Skiroi kishte krijuar e mbante lidhje me albanologë të huaj me emër, si Auguste Dozon e Gustav Meyer, me figura të shquara të lëvizjes patriotike e kulturore shqiptare, si Thimi Mitko, Kostandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Faik Konica, Luigj Gurakuqi etj., si dhe kishte njohur apo bashkëpunuar me bashkatdhetarë të tij të shquar, si Jeronim de Rada, Zef Serembe, Dhimitër Kamarda, Francesco Crispi etj. Të gjithë këta, kush më shumë e kush më pak, kishin treguar interes për gjuhën shqipe: për prejardhjen dhe historinë e saj, kultivimin, pastrimin e pasurimin, krijimin e një varieteti letrar të përbashkët etj. Skiroi ka qenë kështu në dijeni mbi punën e Kristoforidhit për lëvrimin e shqipes përmes përkthimit të shkrimeve të shenjta në të dy dialektet e saj si dhe të përpjekjeve për t’i afruar ato¹⁷. Ka ditur, po ashtu, qëllimin, idetë dhe shkrimet e Konicës të botuara në revistën *Albania* për krijimin e një shqipeje të përbashkët me funksione letrare, apo të “letrarishtes”, siç e quante Konica¹⁸. Ka njohur në mënyrë të hollësishme veprimtarinë dhe shkrimet e De Radës lidhur me shqipën në përgjithësi si dhe idenë që ai kishte për ngritjen e gjuhës së veprave të tij në nivelin e një gjuhe letrare për mbarë shqiptarët, ide me të cilën Skiroi

¹⁵ “... këtë sprovë modeste për një gjuhë të përbashkët të mundshme ende nuk e konsideroj as të plotë e as të përkryer, për më tepër që këtë herë nuk kam patur synim tjetër përveçse të bëj një përpjekje të parë” (Schirò, *Mili e Haidhia*, 60).

¹⁶ “... me qëllimin kryesor për të kontribuar, aq sa kam mundur, për krijimin e një gjuhe letrare kombëtare, nisur nga dëshirat e shprehura vazhdimisht prej shkrimtarëve tanë më me autoritet” (Ibid., 59).

¹⁷ Giuseppe Schirò, “Della lingua Albanese e della sua letteratura anche in rapporto alle colonie albanesi d’Italia”. Në *Annuario del Reale Istituto Orientale di Napoli* (Napoli: Istituto Orientale di Napoli, 1917-1918 (ribotuar në Giuseppe Schirò, *Opere*, VIII, Saggi, përg. Matteo Mandalà (Cosenza: Rubbettino Editore, 1997), f. 108.

¹⁸ Këtë mund ta hamendësojmë prej faktit që Skiroi e përmend që në paragrafin e parë të pasthënies së tij përkthimin në frëngjisht dhe botimin prej Faik Konicës të *Albania* të poemës *Mili e Haidhia*, çka flet për një njohje të veprimtarisë së njëri-tjetrit (Schirò, *Mili e Haidhia*, 57).

nuk qe aspak dakord për arsye që i shpreh hapur dhe qartë¹⁹. Së fundi, por shumë e rëndësishme, Skiroi, që e njihte mirë veprën e Kamardës, i njihte këtij edhe meritën që për herë të parë kish ndërmarrë një sprovë për krijimin e një gjuhe letrare shqipe të përbashkët²⁰.

Skiroi, megjithatë, nuk u mjaftua vetëm me njohjen e disa prej problemeve gjuhësore të shqipes së kohës, por u përpoq edhe të diskutonte mbi to. Shkrimet e tij me karakter gjuhësor, në krahasim me ato të natyrës etnografike, historike, historiko-letrare e politike, janë të pakta dhe, për hir të së vërtetës, pa ndonjë vlerë të spikatur²¹. Ai trajtoi në to më së shumti çështje të etimologjisë së shqipes²² si dhe të marrëdhënieve të mundshme mes paraardhëses së shqipes dhe etruskishtes²³. Vetëm në dy raste ai u mor me çështje të shqipes së kohës së tij, siç ishte shkrimi mbi unifikimin e alfabetit të shqipes²⁴ dhe pasthënia e botimit të tretë të *Mili dhe Hajdhia* (1907), ku parashtroi, ndër të tjera, idetë e tij për krijimin e një modeli shqipeje letrare të përbashkët.

Po cili ishte koncepti i Skiroit për rrugën e formimit të një gjuhe letrare? Ai kishte bindjen që një gjuhë letrare nuk mund të ngrihej përveçse mbi një dialekt të caktuar, në të cilin ishte lëvruar një letërsi me vlera të spikatura²⁵. Në rastin e shqipes, megjithatë, ai mendonte se një model i tillë nuk mund të

¹⁹ “Dialekti i arbëreshëve të Italisë, ashtu siç paraqitet në veprat e De Radës, është më pak i kuptuari nga shqiptarët, kudo ku ata ndodhen; që, për më tepër, merret vesh vetëm në vija të përgjithshme, dhe jo gjithmonë, për shkak të barbarizmave të shumta dhe mjaft fjalëve të trilluara, pa kurrfarë nevoje dhe, për më tepër, pa mjeshtëri; për shkak të jo pak formave gramatikore të papranueshme e të papranuara dhe të paqartësisë së dëshiruar e të kërkuar të konstruktit. Gjuha e De Radës nuk është dhe nuk do të jetë kurrë gjuha letrare e shqiptarëve”. (Giuseppe Schirò, “Appunti di letteratura Albanese contemporanea”. *Nuova rassegna di letteratura moderna*, V. 1908).

²⁰ “...ndër të tjera, u përpoq të realizonte i pari një sprovë të gjuhës letrare shqipe të përbashkët përmes përkthimit të tij të veprës së Dora D’Istria-s, *Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore ...*” (Giuseppe Schirò, “Della lingua ...”, 116).

²¹ Carlo Tagliavini, *La stratificazione del lessico Albanese* (Padova: 1940), f.20. Matteo Mandalà, (përg.) Giuseppe Schirò, *Opere*, VIII..., XIII-XIV.

²² Giuseppe Schirò, “La terza persona singolare del presente indicativo del verbo “jam”, në *La Rassegna italo-albanese*, anno II, n. I, 15 marzo 1920, Palermo, 1920. f. 10-15; n. 3-4, Maggio giugno 1920, Palermo, 1920, f.38-44 (cituar sipas Matteo Mandalà (përg.), Giuseppe Schirò, *Opere*, VIII..., XIII).

²³ Nga punimi i tij në dorëshkrim *Contributo di ricerche intorno all’origine e alla lingua degli Etruschi*, janë botuar postum vetëm dy pjesë, “Il Guttus di Centuripe” dhe “Contributo di ricerche intorno alle origini e alla lingua degli Etruschi” (Matteo Mandalà, (përg.) Giuseppe Schirò, *Opere*, VIII..., 131-152).

²⁴ “Per l’unificazione dell’Alfabeto Albanese”, në *La nuova Albania*, Organo del comitato politico albanese di Napoli, a. II, n. 20, Napoli, 1 maggio 1899.

²⁵ “... çdo gjuhë letrare ka gjithmonë për bazë një dialekt, sidomos atë që ka mundur të imponohet përmes veprave artistike vërtet të shquara...” (Schirò, *Mili e Haidhia*, 60).

zbatohej, pasi jo vetëm nuk ekzistonte ndonjë letërsi me vlera shkruar në ndonjërin prej dialekteve, por edhe pse të gjitha dialektet e shqipes përmbanin elemente të hershme e origjinale, që duheshin marrë në konsideratë²⁶. Këto elemente, sipas tij, ishte munduar t'i identifikonte përmes një studimi krahasues edhe me gjuhë të afërta me shqipen [sic!]²⁷, rezultatet e të cilit premtonte t'i bënte të njohura në një *Gramatikë të krahasuar të gjuhës shqipe*²⁸.

Skiroi, edhe pse ishte për krijimin e një shqipeje letrare me bazë ndër-dialektore²⁹, nuk e mohonte që gjuha e variantit të tretë të poemës së tij, me gjithë ndryshimet që i kishte bërë, vazhdonte të kishte në bazë dialektin toskë³⁰ (kupto: atë arbëresh), por një variant më të hapur tashmë ndaj elementeve toske të atdheut historik. Një pjesë e ndryshimeve që ai bëri, ishin pikërisht zëvendësime të trajtave fonetike e gramatikore dhe të fjalëve prej të folmeve arbëreshe me trajta e fjalë më të përgjithshme të toskërishtes ose dhe të mbarë shqipes³¹: *siizit* → *syyt*, *klofshe* → *qofsh'*, *e glat* → *e gjatë*, *u* → *un'*, *ng'* → *s'*, *dii* → *dyy*, *nkaa* → *nga*, *kishën* → *kishin*, *rroniis* → *vetja*, *tue mbjedhur* → *tue mbledhur*, *t'i flisëj* → *t'i fliste*, *çë* → *që*, *e dhezur* → *e kuqe*, *mënd* → *munt*, *ulji* → *unji*, *kriet* → *kryet*, *i friijtur* → *i fryryjtur*, *i mangjepsur* → *i magjepsur*, *shenkëth* → *qukëzë*, *flisjën* → *flisnin*, *shihëj* → *shihite*, *eriish* → *erërash*, *të harepsura* → *të gëzuara*, *jec* → *ec*, *fixhë* → *fytyrë*, *pasqira* →

²⁶ "... në rastin tonë [të shqipes – K.J.] besoj se të gjitha dialektet, për të njëjtën arsye, kanë të drejtë të kontribuojnë në formimin e gjuhës sonë të përbashkët si për faktin se të gjitha ato ruajnë ende elemente origjinale me vlerë, që nuk do të ishte as e drejtë e as e dobishme të injoroheshin; ashtu edhe pse, për hir të së vërtetës, jemi larg së patur kryevepra në sferën e kufizuar e shumë pak të kultivuar të letërsisë sonë" (Ibid., po aty).

²⁷ "Vetëm një studim i vëmendshëm e serioz i dialekteve të shqipes, krahasuar me gjuhë të tjera të afërta, mund ta çojë një shkrimtar në njohjen e formave të hershme dhe origjinale të ruajtura nga pak kudo në gjuhën e folur, pak a shumë në mënyrë të plotë ..." (Schirò, *Mili e Haidhia*, 59).

²⁸ "Rezultatet që kam mundur të arrij përmes këtyre kërkimeve të mundimshme, shpresoj t'i bëj publike shumë shpejt te *Gramatikë e krahasuar e gjuhës shqipe...*" (Schirò, *Mili e Haidhia*, 60). Një gramatikë e tillë jo vetëm nuk është botuar, por deri më sot nuk është gjetur as ndonjë dorëshkrim i saj.

²⁹ "... u përpoqa shumë të përfitoja nga të dy dialektet kryesore të atdheut-mëmë, pa lënë aspak pas dore nëndialektet dhe duke mbajtur parasysh të folmet italo-shqiptare..." (Schirò, *Mili e Haidhia*, 59).

³⁰ "... ai [teksti – K.J.] është transformuar tani thuajse tërësisht nga pikëpamja gjuhësore dhe, ndonëse vazhdon të ketë në bazë dialektin tosk, përmban veçoritë tipike të dialektit geg..." (Schirò, *Mili e Haidhia*, 57).

³¹ Këto ndryshime përfaqësojnë rreth 5% të fjalëve të përdorura te *Kënga e Milit* dhe *Kënga I* e variantit të tretë. Të gjitha përllogaritjet e paraqitura në këtë artikull duhen konsideruar si vlerësime të përafërta pasi qëllimi është për të krijuar një ide të përgjithshme të masës së ndërhyrjeve dhe ndryshimeve të bëra prej Skiroid.

pasqyrë, zbelonej → *hapej, të ljeta* → *të lehta* etj. Ndër këto ndryshime dallohet, siç mund të shihet, zëvendësimi i trajtave të së pakryerës dëftore dhe lidhore të të folmeve arbëreshe të Sicilisë e të Kalabrisë (*kishën, flisjën, shihëj, zbelonej*) me trajta më të përgjithshme të toskërishtes (*kishin, flisnin, shihthe, hapej*)³², edhe pse, siç pohonte vetë Skiroi, në disa raste ai i ishte shmangur këtij rregulli për arsye metrike dhe eufonie³³.

Përpjekjet e Skiroit “për t’i shpërthyer” e zgjeruar sinorët e idiomës arbëreshe të poemës u bënë edhe në një kah tjetër, atë të hapjes ndaj fjalëve dhe trajtave fonetike e gramatikore të dialektit gegë. Ai zëvendësoi një varg fjalësh prej të folmeve arbëreshe me trajtat përgjegjëse gege, si *kënk* → *kângë, vidhe* → *vidë, ëndërrat* → *ëndërrat, mëë* → *ma, isht* → *âsht, ëmbël* → *âmbël, i vrërët* → *i vrânët, vreshtat* → *vëneshtat, breshri* → *breshëni, bëj* → *bânte, deej* → *dote, e hjeshe* → *e hieshme* etj., ku mbizotëronin dy veçori tipike të gegërishtes veriperëndimore: nazalizmi i zanoreve dhe ruajtja e *n*-së ndërzanore atje ku toskërishtja ka *r*³⁴. Pjesoret toske me rotacizëm, megjithatë, Skiroi i ruajti të pandryshuara në variantin e tretë të poemës (*paa ndëlguar, të paa-djegura, të paa-brezurën, tue mbledhur, dyke vajtur, i fryjytur, i magjepsur, të gëzuara, e përiturë*) për t’i ndryshuar e kthyer ato në trajta me *n* ndërzanore vetëm në variantin e katërt të saj (*të paa-djeguna, të paa-brezunën, tue mbledhun, dyke vajtun, i fryjytun, i magjepsun, të gëzuame, e përितunë*)³⁵.

Procesi i përpunimit të gjuhës së poemës nuk do të ndalej te varianti i tretë i saj, por do të vijonte edhe në një variant të katërt, i cili do të mbetej i pabotuar për rreth 70 vite. Ky variant i gjetur prej studiuesit Matteo Mandalà nuk ishte një variant në dorëshkrim, por, siç na dëshmon vetë Mandalà-ja, “dokumentohet nga faqet e një kopjeje të botimit të tretë, ku Skiroi me dorën e tij ka bërë korrigjime, modifikime dhe plotësime. Bëhet fjalë për ndërhyrje mjaft të dukshme e të shpeshta, që ndeshen rregullisht përgjatë gjithë tekstit

³² “... me të drejtë jam ruajtur që të mos e përdor trajtën me mbaresën –nej, që mbizotëron ndër arbëreshët e Kalabrisë ...” ...” (Schirò, *Mili e Haidhia*, 58).

³³ “Megjithatë, e kam ruajtur nganjëherë, qoftë për arsye metrike, qoftë për eufoni, vetën e tretë njëjës të së pakryerës dëftore dhe lidhore, që përdoret në toskërishten e kolonive të Sicilisë, e ndryshme nga ajo me prapashtesën –te, por që, nga ana tjetër, nuk mungon në dialekte të tjera të atdheut-mëmë, sikurse del edhe te Hahn-i, për shembull *shkoj*, që do të ishte më mire të shkruhej *shkoij*, krahas *shkoj*, që në gegërishten perëndimore është *shkote*, etj.” ...” (Ibid., po aty).

³⁴ Këto ndryshime përbëjnë rreth 2.4% të fjalëve të përdorura te *Kënga e Milit* dhe *kënga I* e variantit të tretë, duke dëshmuar kështu se hapja e gjuhës ndaj dialektit gegë mbetej ende e ulët në krahasim me atë ndaj dialektit toskë të përdorur në atdheun historik (5%).

³⁵ “Po nuk pata kurajon që t’i braktisja plotësisht format pjesore toske, në të cilat *r*-ja përfaqëson një *n* të hershme të ruajtur në gegërishte ...” (Ibid., po aty).

shqip...”³⁶. Ripunimi i veprës, meqenëse nuk ka asnjë të dhënë se kur është kryer saktësisht, merret me mend që do të jetë bërë diku gjatë periudhës pas botimit të variantit të tretë dhe 1927-s, që shënon vitin e vdekjes së autorit. Pikërisht gjatë kësaj periudhe Skiroi ndërmori për herë të parë në jetën e tij një vizitë në Shqipëri, ku qëndroi prej mesit të v. 1913 e deri në mesin e v. 1914. Një pjesë të madhe të kohës atje ai e kaloi, sikurse na dëshmon, në kontakt të ngushtë me popullsinë malësore në trevën e Mirditës³⁷. Në këto rrethana është më se e kuptueshme pse Skiroi nuk u ndal, po e vijoi ndërmarrjen për gegëzimin e mëtejshëm të modelit të tij të shqipes letrare. Janë të shumta fjalët prej të folmes arbëreshe të autorit, që ky i zëvendësoi me fjalë gege, si *fiill* → *çutarri* “rërke, çutërr”, *të trëmburith* → *të frigëshim*, *haree* → *gazimend/gazment*, *njize* → *heret*, *ta vërrej* → *ta këqyrte*, *arruu* → *mrîni*, *somenat* → *heret nadje*, *paa ndëlguar* → *pa kujtue* “*pa kuptuar*”, *e fshehtë* → *e prujtë* “*modeste*”, *u qet* → *heshti*, *u afrua* → *ju qas* “*iu afrua*”, *laftariste* → *rrahte* “*rrihte*”, *të llamparisme* → *të shkëlxyeshme*, *vetja* → *vetvedi*, *mori* → *zuuni*, *reen* → *merë* etj. Njëkohësisht ai vijoi edhe zëvendësimin e mëtejshëm të “arbëreshizmave” me fjalë të leksikut të përgjithshëm shqip ose tosk, si *gjella* → *jeta*, *rehjezit/rehjet* → *kodrat* etj.

Shtimin e leksikut gegë Skiroi e shoqëroi edhe me përdorimin gjithnjë e më të madh të trajtave fonetike e gramatikore gege të fjalëve. Bien në sy një varg fjalësh që në variantin e tretë dalin me trajta me rotacizëm, kurse në variantin e katërt shfaqen me trajta me *n* ndërzanore, si *buroj* → *bunoj*, *dashuriis* → *dashhtëniis*, *dimbri* → *dimni*, *i fryyjtur* → *i fryyjtun*, *i magjepsur* → *i magjepsun*, *tue mbledhur* → *tue mbledhun*, *të paa-brezurën* → *të paa-brezunën*, *të paa-djegura* → *të paa-djeguna*, *parë* → *pamun*, *e përiturë* → *e përitun* etj. Po kështu, janë shtuar rastet e përdorimit të infinitivit me + pjesore në vend të trajtave të lidhores, si *t'i fliste* → *me folun*, *ta shëkoj* → *me shique* etj.

Nuk mund të lihet pa përmendur edhe një dukuri që, ndonëse në mënyrë të kufizuar, shfaqet që në variantin e tretë të poemës e vijon edhe në të katërtin. Është fjala për disa trajta që nuk ekzistojnë, por që Skiroi i krijoi duke përzier modele fonetike e gramatikore toske dhe gege: *dyke vajtur* → *dyke vajtun*, *llorët* → *llônë* “*llërë*”, *e përiturë* → *e përitunë* “*e pranuar*” etj.

Pra, ndryshimi dhe pasurimi i gjuhës së variantit të katërt të idilit *Mili e Haidhia* është bërë më së shumti për kah gegërishtja e shumë më pak për nga toskërishtja dhe trajtat e përgjithshme të shqipes, por gjithmonë duke ruajtur

³⁶Matteo Mandalà, (përg.) Giuseppe Schirò, *Opere*, II..., f. XIV.

³⁷“... në qëndrimin tim jo të shkurtër në Shqipëri, ku jetova në kontakt të drejtpërdrejtë me malësorët dhe veçanërisht me mirditorët trima”, “Della lingua Albanese e della sua letteratura..., vep. cit., (Matteo Mandalà, (përg.) Giuseppe Schirò, *Opere*, VIII..., 88).

dukshëm bazën dialektore arbëreshe, d.m.th. modelet fonetike e gramatikore të këtij dialekti³⁸.

A ia doli Skiroi të krijonte një model shqipeje letrare të përbashkët si një përzierje ndër-dialektore mes toskërishtes, gegërishtes dhe arbërishtes, sikurse kishte parashtruar në pasthënien e variantit të tretë të *Milit e Haidhisë*? Nisur nga ballafaqimi mes parimeve e kriterëve teorike dhe gjuhës së sendërtuar konkretisht në dy variantet e fundit të idilit, mund të thuhet se nuk ia arriti. Skiroi, edhe pse u përpoq të përfshinte në gjuhën e poemës disa modele fonetike e gramatikore tipike të gegërishtes, këto mbetën në një numër të kufizuar dhe nuk u integruan natyrshëm në gjuhë³⁹. Veç kësaj, këto prurje nuk arritën ta ndryshonin bazën dialektore të gjuhës së poemës, e cila identifikohet qartë e lehtë si arbërishte. Skiroi u tregua ndërkaq shumë më i hapur për përfshirjen në gjuhën e poemës të leksikut toskë të përgjithshëm si dhe të atij gegë duke zëvendësuar një numër të madh fjalësh të dialektit arbëresh. Në aspektin leksikor ai arriti të kryente një përzierje të vërtetë të elementeve prej të tre dialekteve të shqipes, çka karakterizon jo vetëm këtë veprë të tij, por edhe vepra të tjera⁴⁰. Nuk janë të pakta madje rastet kur fjalë dialektesh të tjera të njohura prej tij, Skiroi i përdori si bazë për krijime neologjike duke u dhënë këtyre ndonjëherë kuptime krejt të veçanta e që nuk lidheshin me temat fjalëformuese (*shkulmore, flesheja* etj.).

Ky model shqipeje e përbashkët u frymëzua dhe lindi i nxitur e i ushqyer më së shumti prej idealeve patriotike sesa atyre shkencore-gjuhësore të Skiroit⁴¹. Ai nuk pati mundësi të njihej e, për më tepër, të përhapej ndër

³⁸ Kjo prirje, siç dëshmon Matteo Mandala, karakterizoi edhe gjuhën e veprave të tjera të tij të mbetura në dorëshkrim të hartuara përgjatë periudhës 1920-1927 (Matteo Mandala, (përg.) Giuseppe Schirò, *Opere*, II..., XVI).

³⁹ Këtë e ka vënë në dukje edhe Namik Ressuli, kur thonte se "...ai nukë cakton një sistem të vetëm e të qëndruarshëm fonetik e morfologjik për këtë gjuhë të përbashkët e t'i mbahet, gjithënjë e pa përjashtim, besnik kësaj. Ai nukë na thotë se cilat trajta toskërishte e gegërishte duhen përdorur e cilat duhen lënë, po vet përdor të njëjtën trajtë herë sipas toskërishtes herë sipas gegërishtes pa dallim rase" (Namik Ressuli, "Përpjekje të hershme e të vona për një gjuhë shqipe të përbashkët". *Shkëndija*, nr. 4. (Tiranë: 1940), 28).

⁴⁰ "Për sa i përket fjalorit, përkundër, Schirò-i, me plotë arësye e me aftësi të rallë ka shfrytëzuar të gjithë pasurinë leksike të dialekteve e të nën-dialekteve shqipëtare e italo-shqipëtare; gjuha e tij prandaj është shumë e pasur, ndohta më e pasura e të gjithë shkëmbit italo-shqipëtarë, e meriton të studjohet e të merret si shëmbëll nga të gjithë shkëmbit tjerë" (Ressuli, "Përpjekje ...", 29).

⁴¹ Në v. 1913 veprimtaria studimore e Skiroit iu nënshtua vlerësimit prej një komisioni *ad hoc* të ngritur pranë Institutit Oriental të Napolit, i cili kishte për detyrë të shqyrtonte "performancën profesionale" të gjithë personelit akademik të atij institucioni. Skiroi u çmua prej tij më shumë si letrar sesa si filolog e, në këtë kuadër,

shqiptarët duke mbetur i kufizuar vetëm brenda veprës së tij. Modeli gjuhësor që përpunoi Skiroi, edhe pse shumë më i kuptueshëm se ai që përpunoi Kamarda 4-5 dekada para tij, pati të njëjtin fat me këtë të fundit. Të dy mbetën në analet e historisë së përpjekjeve për një gjuhë të përbashkët kombëtare. Vetëm një dekadë pas botimit të variantit të tretë të *Milit e Haidhisë* (1907) një institucion si *Komisia Letrare e Shkodrës* (1916) do t'i jepte zgjidhje çështjes së një shqipeje të përbashkët, ndonëse përkohësisht dhe si një varietet thjesht me funksione zyrtare.

Shtojca 1

Kënk e Milit (ii)

(A)⁴² kënk
 (A) vidhe
 (A) siizit
 (AT) e fshehur
 (AT) ëndërrat
 (A) klofshe
 (A) e glat
 (A) e t'ëmbël
 (A) mëë
 (A) e hieshme
 (AT) e paa-njohur
 (ATG) haree
 (A) isht
 (A) dimbri
 (A) njize
 (A) bënet
 (A) u
 (A) të deja
 (A) ng'
 (A) vëlen
 (A) lulje
 (A) heja
 (A) mbjeth
 (AT) dashuriis
 (A) shpii

Kângë e Milit (iii)

(G) kângë
 (G) vidës
 (TG) syyt
 (AT) e fshehtë
 (G) ândërrat
 (TG) qofsh'
 (TG) e gjatë
 (A) e kërkushme
 (G) ma
 (G) e hieshme
 (N) e paa-njohta
 (ATG) haree
 (G) âsht
 (A) dimbri
 (A) njize
 (H) bânet
 (TG) un'
 (A) të deja
 (TG) s'
 (A) vëlen
 (A) lulje
 (A) heja
 (A) mbjeth
 (AT) dashuriis
 (T) shtëpii

Kângë e Milit (iv)

(G) kângë
 (G) vidës
 (TG) syyt
 (G) e prujtë "modeste"
 (G) ândërrat
 (TG) qofshe
 (TG) e gjatë
 (A) e kërkushme "e ëmbël"
 (G) maa
 (G) e hieshme
 (N) e paa-njohta
 (G) gazimend
 (G) âsht
 (G) dimni
 (G) heret
 (H) bânet
 (TG) un'
 (T) të doja
 (TG) s'
 (TG) vlen
 (TG) lules
 (N) flesheja "bukuria"
 (T) mblodh
 (G) dashtëniis
 (T) shtëpii

puna e tij për krijimin e një shqipeje të përbashkët u vlerësua si "... hapi i parë për arritjen e një ideali fisnik". (Ressuli, *Giuseppe Schirò ...*, 151-152).

⁴² A - arbërisht, AT – arbërisht, toskërisht, ATG – arbërisht, toskërisht, gegërisht, G - gegërisht, H – krijim hibrid, N – neologjizëm, T- toskërisht, TG – toskërisht, gegërisht, Ø – fjala është hequr.

(ATG) e lumja	(TG) e lume	(TG) e lume “e bekuar”
(A) paa ndëlguar	(A) paa ndëlguar	(G) pa kujtue “pa kuptuar”
(A) dii	(TG) dyy	(TG) dyy
(AT) ushtre	(T) kallza	(T) kallza
(A) tue u trazhguar	(A) tu’ u trazhguar	(G) tue trazhgue
(A) shenk	(A) shenk	ø
(A) lipset	(TG) lypset	ø

I (II)

(A) kënkës
 (AT) ëmbël
 (AT) buroj
 (A) nkaa
 (A) fillth
 (A) menat
 (AT) truat
 (AT) ëndërrash
 (A) i vrërët
 (AT) mori
 (ATG) harees
 (AT) gjelbërojën
